

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

Pranuar më: 01-08-2018		
Prinçjeno:		
Njesia Jediniça	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-400-	47928	



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 01.08.2018

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve Kulturore për bashkorganizimin e festivalit "Lipjani Këndon"

1. Komuna e Lipjanit konkretisht Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës OJQ-ve që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në fushën e Kulturës, që të aplikojnë për mbështetje financiare për Organizimin e festivalit "Lipjani Këndon"

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin e Kulturës sipas fushës:

a) Kulturore, për organizimin e festivalit "Lipjani Këndon"

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e Kulturës në Komunën e Lipjanit.

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune pas publikimit dhe përfundon me datën 21.08.2018, në ora 15:00h

5. OJQ-të nuk mund të aplikojnë më se shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje. Periudha e zbatimit të projektit është për 2 muaj.

6. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës. Organizatat e Shoqërisë Civile aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Kulturës. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj

Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ-të dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-të ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

**KOMUNA E LIPJANIT**

**Rruga „Shqipëria“**

**Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,**

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [bekim.g.shabani@rks-gov.net](mailto:bekim.g.shabani@rks-gov.net) ose nr kontaktues: **038 200 41 536**, orari **08:00h -16:00h**.

Kryetari i Komunës së Lipjanit

z. Imri AHMETI

